



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.350/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj -kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Hidajete Gashi Alaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e parashtruara nga kandidatja për Kuvendin e Komunës së Prizrenit, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetvendosje, Dafina Shehu, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 27.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

Hedhen të pasafatshme ankesat ZL.Anr.350/2025, ZL.Anr.351/2025, ZL.Anr.352/2025, ZL.Anr.353/2025, ZL.Anr.354/2025, datë 25.10.2025, të parashtruara nga Dafina Shehu kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), në Prizren, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 25.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat e parashtruara nga kandidatja për Kuvendin e Komunës së Prizrenit, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetvendosje, Dafina Shehu, ZL.Anr.350/2025, ZL.Anr.351/2025, ZL.Anr.352/2025, ZL.Anr.353/2025, ZL.Anr.354/2025, në të cilat pretendohet se në vendvotimet në Komunën e Prizrenit, me numrat 2005/4, 2075/06, 2010/04, 2028/01, 2001/03, 2023/04, gjatë numërimit të votave, ka pasur parregullësi, ku në kutinë me nr. 2005/04, dhe 2075/06, sipas dëshmisë së vëzhguesit të QKN-së në Prizren duhet të ishin 8 (tetë) vota, pasi që vëzhguesit kishin kuptuar manipulimin e votave në këtë kuti, dhe kinse me janë kthyer votat për mua në sistem nuk figurojnë më shumë se 3 (tri) vota. Në kutinë me nr. 2023/04 në QKN, mungojnë 3 (tri) vota dhe një fletëvotim i është dëmtuar por nuk dihet saktë se ku ka ndodhur shkelja e supozuar në klasë apo në QKN. Në vendvotimin 2023/04, i kanë ngatrruar numrat nga nr. 26 në nr. 29, në vendvotimin ku kanë votuar familjaret e saj. Në fshatin Zojz, në vendvotimin 2028/01, votat e saj nuk kanë dalur edhe pse e kanë votuar. Në kutinë 2001/03, sipas dëshmisë së vëzhguesit në kutinë 2001/03, sipas dëshmisë së vëzhguesit të Lëvizjes Vetvendosje, gjatë procesit të

numërimin janë parë katër vota në favorin tim, megjithatë, në sistem figurojnë vetëm 3 (tri) vota të regjistruara, andaj duke u bazuar në mospërputhje të votave kërkon që të bëhet rishikimi dhe rinumërimi i votave për këtë klasë/kuti në mënyrë që të sigurohet saktësia dhe transparenca e procesit zgjedhor, si dhe rishikim dhe rinumërim i të gjitha kutive të cekura në ankesë.

Në përgjigje në ankesë të KQZ-së, datë 25.10.2025, sqaron se pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese, të kandidatës për kuvendin komunal në Prizren, nga subjekti politik Lëvizja Vetvendosje, Dafina Shehu theksohet se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Me tutje KQZ thekson se sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe familjarëve të tij, duke theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit.

Andaj, pas analizimit të lëndës është vërejtur se pala ankuese ankesat i ka paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitjen e ankesave, sepse pas konfirmimit të ZEKKKZ në komunën e Prizrenit, aktiviteti i QKN-së është përmbyllur me datën 18.10.2025, në ora 22:10 ndërsa pala ankesat i ka parashtruar me datën 25.10.2025. Pra nuk është brenda afatit ashtu siç parashihet me nenin 105, par.1 të LZP. Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes se supozuar.

KQZ, ju njofton se, rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevojë të veçantë; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimeshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre.

Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LZP, pala mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Po ashtu, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se palët ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e saj të paraqitura në ankesë. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve – QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.Anr.350/2025, ZL.Anr.351/2025, ZL.Anr.352/2025, ZL.Anr.353/2025, ZL.Anr.354/2025, të datës 25.10.2025 të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët ZL.A.nr.350/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesave dhe shkresave të lëndës konstaton se:

- Ankesat janë të pasafatshme

PZAP pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore të ankueses si dhe përgjigjes së dhënë nga KQZ vërtetohet se parashtruesja e ankesave i ka dorëzuar ankesat me datë 25.10.2025, ku ka pretenduar se ka pasur parregullsi në numërim të votave, ndërsa sipas përgjigjes nga KQZ dhe provave të bashkangjitura procesi i numërimit në Qendër Komunale është përmbyllur me datë 18.10.2025.

Sipas Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nenit 105 paragrafi 1, përcaktohet se *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.”*

Po ashtu sipas nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, përcaktohet se *“Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara.”* Ndërsa neni 13 paragrafi 3, i të njëjtës rregullore përcakton se *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.”*

PZAP vëren se nga përgjigja e KQZ është vërtetuar fakti se aktiviteti i QKN-së në Komunën e Prizrenit, është përmbyllur më datë 18.10.2025, kurse ankuesi ankesën e ka parashtruar në PZAP me datë 25.10.2025, me çka vërtetohet se ankesa e ankueses është parashtruar pas shtat ditëve respektivisht nuk është paraqitur brenda 48 orëve ashtu siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli, ka gjetur se ankesat e parashtruara nga kandidatja për anëtare të Kuvendit të Komunës në Komunën e Prizrenit Dafina Shehu, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetvendosje (LVV), për shkak të parregullsive në numërim të votave, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuara me dispozitat e lartcekura, andaj PZAP vendosi që ankesat e ankuesës të hedhen si të pasafatshme.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 105 paragraf 1 i LZP-së, nenit 117 paragrafi 3, dhe nenit 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në

Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 9 paragrafi 5, nenin 13, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës Nr.1/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijs së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.350/2025, datë 27.10.2025

Kryesuese e Panelit

Kymete Kica



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.